



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program

Gjuhë dhe Letërsi Gjermane (2022/2023)

Fakulteti	Gjuhët, Kulturat dhe Komunikimi
Cikli i studimeve	Cikli i parë (Deridiplomike)
SETK	240
Kodi	DE-240
Titulli	Profesor i diplomuar i gjuhës dhe letërsisë gjermane
Numri në arkiv i akreditimit [240]	03-1331/1
Numri në arkiv i akreditimit []	
Vendimi për fillim me punë	
Data akreditimit	04.05.2022

Përshkrimi i programit

Struktura e programit përmban studime, të cilat nga natyra janë dinamike, integruese dhe ndërvepruese. Programi është dizajnuar të ofrojë qasje integruese në tema nga fusha e gjuhëve, kulturave dhe komunikimeve, duke e implementuar këtë koncept nëpërmjet programit mësimor. Lëndët të cilat janë përfaqësuar në këtë program paraqesin perspektiva, që bazohen në teorinë, e cila është e lidhur ngushtë me aplikimin praktik në botën e gjuhës, kulturës, artit, arsimit dhe komunikimit.

Qëllimet kryesore të programit janë:

- T'i përgatisë studentët për pozitën e udhëheqësit në institucionet dhe organizatat arsimore, kulturore dhe shkencore në vend dhe kudo në botë.
- T'i përgatisë studentët për ndërtimin e karrierës në fushën e profesionit të tyre në sektorin shtetëror, privat dhe joqeveritar.
- Të ofrojë një sërë modulesh që përfshijnë thelbin e dijes për përafrimin ndaj profesioneve, të cilat më pak ose më shumë janë të lidhura me fushën e arsimit dhe kulturës.
- Ta mundësojë arritjen e shkathtësive kërkimore dhe përvojë për gjuhën, literaturën dhe kulturën në organizatat publike, private dhe ndërkombëtare.
- Ta zhvillojë konceptin e mendimit kritik te studentët.
- Ta mundësojë qasjen aktive të studentëve në ligjëratat dhe në kryerjen e kërkimeve të pavarura në të gjitha fushat e organizatave shoqërore, arsimore, kulturore dhe shkencore.
- Ta mundësojë zhvillimin e shkathtësive personale, pastaj shkathtësitë e komunikimit, për kërkime dhe shkathtësi të tjera të rëndësishme të cilat janë të nevojshme për punësim.

Programi për studime deridiplomike studentëve u mundëson kuptim të thellë dhe njohuri nga fusha e arsimit dhe kulturës, ndërkohë i orienton në fusha të caktuara, të cilat do të specializohen në vitin e fundit të studimeve. Përbërja e programit studimor ka për qëllim kombinim të balancuar të njohurive themelore dhe shkathtësive specifike profesionale. Viti i parë është i rëndësishëm për studentët, për shkak se ndërlihd një spektër të plotë të lëndëve ndërdisiplinore. Kjo do të ketë dobi

të konsiderueshme për formimin e tyre profesional.

Karriera

Të diplomuarit e këtij programi studimor posedojnë njohuri, shkathtësi dhe kompetenca, të cilat u mundësojnë atyre vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë përkatësisht studimeve Master nga gjuha, letërsia dhe kultura gjermane, ose ta fillojnë karrierën e tyre si mësimdhënës bashkëkohorë të gjuhës gjermane në shkollat fillore dhe të mesme, ose në shkollat private. Përveç kësaj modulet nga fusha e gjuhësisë, letërsisë, kulturës dhe didaktikës i aftësojnë për kryerjen e veprimtarive të tjera në: administratën shtetërore dhe marketing, në shërbimin diplomatik, në Institucione publike dhe private, ose si përkthyes dhe interpretues, në forcimin e marrëdhënieve gjermane-maqedonase, në sferën e politikës, kulturës dhe ndërmjetësimit kulturor, veprimtari në fushën e gazetarisë, si dhe në shtëpitë botuese, në ndërmarrjet ndërkombëtare ose në turizëm..

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

- Të ketë njohuri dhe kuptim nga sfera e studimeve gjermane, të cilat ndërtohen mbi arsimin e tyre të mesëm të përgjithshëm.
- Të fitojë kompetenca të mira gjuhësore të gjuhës gjermane në raport me katër aftësitë gjuhësore (të folurit, të dëgjimit, të leximit dhe të shkruarit).
- Të ketë njohuri dhe kuptim të çështjeve kulturore, të cilat kanë të bëjnë me shtetet në të cilat flitet gjuha gjermane dhe të mund të analizojë dhe të vlerësojë në mënyrë kritike gjuhën, letërsinë, historinë, shoqërinë dhe mediumet gjermane.
- Të mundet t'i kuptojë periudhat e ndryshme dhe autorët e mëdhenj të letërsisë së vendeve, ku flitet gjuha gjermane.
- Të njihet me një spektër të strategjive dhe resurseve mësimore, duke kyçur teknologji për nxitjen e interesit dhe përkrahjen për mësim të gjuhës gjermane si gjuhë e huaj.

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- Të jenë të aftë për aplikimin e shkathtësive të tyre metodologjike në profesionin e tyre si mësimdhënës nëpër shkollat fillore dhe të mesme.
- Të jenë të aftë për aplikimin e njohurive të tyre për përkthim zyrtar gjyqësor nga gjuha gjermane në shqip, apo maqedonisht dhe anasjelltas.
- Ta shfrytëzojnë gjuhën gjermane në formë të përshtatshme në situata të ndryshme akademike dhe sociale.
- Të ndërtojnë dhe mbështesin argumente dhe të zgjedhin probleme në sferën e tyre të lingistikës, letërsisë, kulturës dhe metodikës gjermane.

Aftësitë për të vlerësuar

- Të mund të analizojnë pyetje dhe debate bashkëkohore në bazë të njohurive të tyre gjuhësore, kulturore dhe letrare.
- Të mund ta vlerësojnë përshtatshmërinë e teknikave studimore, të cilat ngërthejnë stile të ndryshme të mësimin në klasë, ku mësohet gjuha gjermane si gjuhë e huaj.
- Të vlerësojnë dhe analizojnë tekste të ndryshme nga letërsia, duke u kujdesur për gjuhën, stilin, simbolet dhe metaforën. Të krahasojnë dhe dallojnë tekste letrare përgjatë kohëve dhe popujve të ndryshëm.
- T'i mbledhin dhe interpretojnë të dhënat themelore të lingistikës, të cilat kanë të bëjnë me gjuhën gjermane.

Aftësitë e komunikimit

- Të komunikojnë në mënyrë efektive me studentët dhe nxënësit në ambiente të klasës.
- Të prodhojnë dhe të organizojnë shprehje të qarta gramatikore dhe fjali komplekse (të përbëra).
- Të komunikojnë në gjuhë gjermane me vokabular të përshtatshëm profesional, si për publikun e veçantë, ashtu edhe për atë jo të veçantë.
- Të debatojnë me mendim të informuar për aspekte të ndryshme të trendëve kulturore gjermane, mendimtarëve dhe ndodhive historike.

Aftësitë e të mësuarit

- Të kenë shkathtësi autonome për mësim dhe të jenë të vetëmotivuar për arritjen e qëllimeve profesionale përmes

përdorimit të pavarur të materialeve autentike.

- Në mënyrë sistematike të zhvillojnë shkathtësi produktive dhe perceptuese në kontekst të studimeve gjermane.
- Të kenë aftësi për zhvillimin e teknikave dhe materialeve të ndryshme studimore në lidhje me situatën e tyre studimore.

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [CGL-102] [6.0 SETK] **Hyrje në linguistikën gjermane**
- [CGL-103] [6.0 SETK] **Hyrje në studimet e letërsisë gjermane**
- [CGL-101] [6.0 SETK] **Gjuhë e sotme gjermane I**
- [3.0 SETK] **Gjuhë shqipe/maqedonase**
- [3.0 SETK] **Gjuhë angleze**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore/Kompetencat digjitale**

Semestri 2

- [CGL-203] [6.0 SETK] **Gjuhë e sotme gjermane II**
- [CGL-204] [6.0 SETK] **Fonetika dhe fonologjia e gjuhës gjermane**
- [CGL-201] [6.0 SETK] **Letërsia gjermane e shek. 18**
- [3.0 SETK] **Gjuhë angleze**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore/Kompetencat digjitale**
- [3.0 SETK] **Gjuhë shqipe/maqedonase**

Semestri 3

- [CGL-301] [6.0 SETK] **Gjuhë e sotme gjermane III**
- [CGL-304] [6.0 SETK] **Morfologjia e gjuhës gjermane**
- [CGL-303] [6.0 SETK] **Letërsia gjermane e shek. 19**
- [EGL-401] [6.0 SETK] **Përkthim nga gjermanishtja në shqip/maqedonisht**
- [C2069] [3.0 SETK] **Komunikim verbal**
- [3.0 SETK] **Gjuhë angleze**

Semestri 4

- [C2070] [3.0 SETK] **Komunikim me shkrim**
- [CGL-605] [6.0 SETK] **Përkthim nga shqipja/maqedonishtja në gjermanisht**
- [CGL-404] [6.0 SETK] **Sintaksa e gjuhës gjermane**
- [CGL-401] [6.0 SETK] **Gjuhë e sotme gjermane IV**
- [CGL-405] [6.0 SETK] **Letërsia gjermane e shek. 20 (1900-1945)**
- [3.0 SETK] **Gjuhë angleze**

Semestri 5

- [CGL-501] [6.0 SETK] **Gjuhë e sotme gjermane V**
- [CGL-504] [6.0 SETK] **Leksikologjia e gjuhës gjermane**
- [CGL-503] [6.0 SETK] **Metodologjia e mësimdhënies së gjermanishtes si gjuhë e huaj I**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore nga njësi tjera**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore e përgjithshme (nga PS)**

Semestri 6

- [CGL-601] [6.0 SETK] **Gjuhë e sotme gjermane VI**
- [CGL-603] [6.0 SETK] **Metodologjia e mësimdhënies së gjermanishtes si gjuhë e huaj II**
- [CGL-602] [6.0 SETK] **Gramatika dhe mësimdhënia e gramatikës**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore nga njësi tjera**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore e përgjithshme (nga PS)**

Semestri 7

- [C2167] [6.0 SETK] **Kompetenca receptive dhe produktive e tekstit I**
- [CGL-702] [6.0 SETK] **Fjalëformimi i gjuhës gjermane**
- [C2628] [6.0 SETK] **Linguistika kontrastive**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore e përgjithshme (nga PS)**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore profesionale (nga drejtimi)**

Semestri 8

- [C2168] [6.0 SETK] **Kompetenca receptive dhe produktive e tekstit II**
- [EGL-601] [6.0 SETK] **Historia e gjuhës gjermane**
- [C2629] [6.0 SETK] **Teoria dhe praktika e mësimdhënies së gjermanishtes si gjuhë e huaj**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore e përgjithshme (nga PS)**
- [6.0 SETK] **Zgjedhore profesionale (nga drejtimi)**

Description of courses

Lëndë obligative

- **Hyrje në linguistikën gjermane**

Qëllimi i lëndës Hyrje në Linguistikën Gjermane është ofrimi i një spektri të gjerë të linguistikën bashkëkohore gjermane. Kjo lëndë ofron hyrje në problemet dhe sferat e kërkimit mbi shkencën e gjuhës, konceptet e saj, metodat dhe rezultatet, si dhe teoritë zhvillimore të saj. Në kuadër të lëndës, do të përfshihen temat vijuese: gjuhë, komunikim dhe semiotikë, fonetikë dhe fonologji, grafematikë dhe ortografi, fjalëformimi dhe lakimi, sintaksa; analiza tradicionale e fjalive, varësia dhe valenca, semantika, sociolinguistika, pragmatika, linguistika tekstuale, etj.

- **Hyrje në studimet e letërsisë gjermane**

Kjo lëndë ka për qëllim të ofrojë një hyrje në letërsinë gjermane, veçanërisht në epokën e letërsisë dhe kulturës gjermane të kohës së mesjetës deri në letërsinë e kohës së tashme, si dhe në terminologjinë e letërsisë në përgjithësi. Në kuadër të kësaj ligjërate, do të përpunohen autorë të rëndësishëm dhe vepra të periudhave të ndryshme, zhanre, etj. Parashihet një hyrje dhe studim të letërsisë gjermane në periudha, duke filluar nga mesjeta, humanizmi, baroku, klasika, romantizmi, ekspresionizmi dhe letërsia e shekullit 20.

- **Gjuhë e sotme gjermane I**

Qëllimi i lëndës është përvetësimi i kompetencave gjuhësore të nivelit A2/1. Në kuadër të lëndës, studentët do t'i përmirësojnë shkathtësitë e veta gjuhësore (lexim, shkrim, të folurit, dëgjim). Përveç kësaj, ata do të fitojnë informata dhe përshtypje për vendet, ku flitet gjuha gjermane dhe do të njihen me ndodhitë bashkëkohore në shtetet gjermanofolëse. Rëndësi e veçantë i kushtohet bisedës, shkrimit, dëgjimit, leximit dhe gramatikës dhe me përfundimin e lëndës studentët duhet të tregojnë njohuri fillestare nga këto shkathtësi. Në mënyrë praktike studentët ushtrojnë shqiptimin dhe intonimin e fjalëve, gramatikën fillestare, strukturimin e fjalive dhe rregullat kryesore të drejtshkrimit. Lexojnë tekste të thjeshta, dialog, letra, tregime etj. Mësim të fjalëve të reja përmes paraqitjes së situatave nga jeta e përditshme.

- **Gjuhë e sotme gjermane II**

Qëllimi i kësaj lënde, para së gjithash, është përfitimi i kompetencave gjuhësore në nivel A2/2. Lënda është vazhdimësi e lëndës Gjuha e sotme gjermane I. Studentët do t'i përmirësojnë shkathtësitë e veta gjuhësore (lexim, shkrim, të folurit, dëgjim). Krahas kësaj, ata do të përfitojnë informata dhe përshtypje për vendet, ku flitet gjuha gjermane dhe do të njihen me ndodhitë bashkëkohore në shtetet gjermanofolëse. Përfitohen shkathtësitë: të dëgjuarit, të kuptuarit, të lexuarit dhe të folurit përmes punës me librin shkollor Schritte international 4 dhe 5. Studentët e praktikojnë shqiptimin dhe intonacionin, gramatikën bazë, strukturat e fjalive dhe rregullat bazë të shkrimit. Lexojnë edhe tekste të thjeshta, dialogë, letra, rrëfime, etj.

- **Fonetika dhe fonologjia e gjuhës gjermane**

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është ofrimi i hyrjes në pjesë të ndryshme të fonetikës dhe të fonologjisë gjermane. Në plan të parë janë bazat fiziologjike të formimit të fjalës, si dhe përshkrimet artikuluse dhe akustike dhe klasifikimi i tingujve (bashkëtingëlloret dhe vokalet). Disa probleme dhe çështje të transkriptimit trajtohen, poashtu në këtë lëndë. Në pjesën e dytë janë prezantuar qasje të ndryshme përshkruese të fonologjisë gjermane dhe diskutohet në gamën e

tyre. Ushtrimet në fonematikë dhe artikulum të gjuhës gjermane, si dhe variacionet e saja e përshkruajnë zbatimin e tyre.

- **Letërsia gjermane e shek. 18**

Kjo lëndë ka për qëllim të ofrojë qasje në historinë e letërsisë gjermane të shekullit 18të. Nga studentët pritet njohje me veprat dhe autorët më të dalluar të kësaj periudhe me qëllim të kuptimit të mënyrës së të menduarit dhe të krijimit të letërsisë gjermane të shekullit 18të. Lënda duhet t'i aftësojë studentët të depërtojnë në motivet për interpretimet dhe krijimin e teksteve të shkruara. Me këtë lëndë, studentët, do të fillojnë me njohjen e lëvizjeve evropiane dhe vlerës së literaturës dhe gjendjes sociale përgjatë Evropës. Me këtë lëndë është paraparë analizë e autorëve dhe temave në vijim nga kjo periudhë e letërsisë gjermane: Gottsched, Lessing, Goethe, Schiller 1. Aufklärung në historinë e kulturës në Evropë dhe në Gjermani. Sturm-und-Drang-Phase. Klasikë gjermane.

- **Gjuhë e sotme gjermane III**

Qëllimi i kësaj lënde, para së gjithash, është përfitimi i kompetencave gjuhësore në nivelin B1/1. Në kuadër të lëndës, do të thellohen njohuritë paraprake, si dhe do t'i jepet vëmendje e veçantë bisedës dhe shkrimit. Të shkruarit ushtrohet dhe zbatohet përmes detyrave të shtëpisë (ese, prezantime, ftesa, etj). Të folurit ushtrohet në klasë (puna në grupe, prezantime, referate, loja, etj). Punohet në mënyrë plotësuese në thellimin e njohurive nga gramatika.

- **Morfologjia e gjuhës gjermane**

Qëllimi i lëndës është t'i njoftojë studentët me termet themelore të morfologjisë gjermane. Në plan të parë të kësaj lënde qëndrojnë para së gjithash llojet e fjalëve (të ndryshueshme dhe të pandryshueshme). Në kuadër të kësaj ligjërate prezantohen dhe sqarohen prej së afërmi vetitë në vijim të gjuhës standarde gjermane: nocionet themelore të morfologjisë (morfema, fjala, klasifikimi i llojeve të fjalëve), folja, klasifikimi i foljeve sipas kriterëve morfologjike, foljet e rregullta dhe të parregullta, klasifikimi i foljeve sipas kriterëve sintaksore, foljet e plota dhe foljet ndihmëse, klasifikimi i foljeve sipas kriterëve semantike, forma infinitiv i foljes: infinitiv, particip 1, particip 2, koha, përdorimi i formave kohore, foljet modale, pasivi, funksionet e aktivitetit dhe pasivitetit, mënyra e foljes: indikativ, konjunktivi 1 dhe 2, imperativ, emrat, kallëzuesit, ndajfoljet, lidhëzat, fjalët modale, etj.

- **Letërsia gjermane e shek. 19**

Kjo lëndë ka për qëllim të ofrojë qasje në historinë e letërsisë gjermane të shekullit 19. Nga studentët pritet njohje me veprat dhe autorët më të dalluar të kësaj periudhe me qëllim të kuptimit të mënyrës së të menduarit dhe të krijimit të letërsisë gjermane të shekullit 19. Lënda duhet t'i aftësojë studentët të depërtojnë në interpretimin e teksteve të ndryshme të kësaj periudhe dhe në krijimin e teksteve të shkruara. Me këtë lëndë, studentët, do të fillojnë me njohjen e lëvizjeve evropiane dhe vlerës së literaturës dhe gjendjes sociale përgjatë Evropës. Me këtë lëndë është paraparë analizë e autorëve dhe temave në vijim nga kjo periudhë e letërsisë gjermane, siç është poetika e autorëve nga periudha e romantizmit dhe realizmit: Kleist, Tieck, Schlegel, Novalis, Hoffmann, Grillparzer, Heine, Büchner, Keller, Fontane Grillparzer, Nestroy, Heine, Büchner, Keller, Fontane.

- **Përkthim nga gjermanishtja në shqip/maqedonisht**

Kjo lëndë ka për qëllim t'i njoftojë studentët me konceptet themelore nga fusha e përkthimit. Fokusi kryesor i kësaj lënde është përkthimi i teksteve nga gjuha gjermane në shqip/maqedonisht. Kjo formë e përkthimit përfshinë përkthimin e teksteve letrare, siç janë: tregimet, novelat, romanet, poezitë, etj. Gjithashtu, do të përkthehen edhe shkrime nga gazetatat dhe revistat e ndryshme.

- **Komunikim verbal**

Objektivat e programit të lëndës: - Të zhvillojnë aftësitë e komunikimit verbal. - Të jenë në gjendje të përfshihen aktivisht në një diskutim mbi një temë të veçantë. - Të zotërojnë teknikat për komunikim të suksesshëm. - Të shprehin mendimin e tyre kritik për tema të caktuara. - Të zbatojnë teknikat e adaptuara në karrierën e tyre profesionale.

- **Komunikim me shkrim**

Objektivat e programit të lëndës: Për të fituar njohuri në lidhje me procesin e të shkruarit (fazat në krijimin e një teksti). - Të miratojnë normat standarde të gjuhës. - Të arrihet një nivel akademik për shprehje me shkrim në shqip, maqedonisht ose anglisht, i cili do të zbatohet njohuritë e marra më parë të gjuhës standarde. - Të inkurajojë motivimin e studentëve për shprehje me shkrim pavarësisht nga llojet dhe format e tekstit. - Të miratojnë kriteret e tekstualitetit, të cilat janë thelbësore për një tekst. - Përvetësimi i aftësive për kërkimin e materialeve (biblioteka dhe burimet online).

- **Përkthim nga shqipja/maqedonishtja në gjermanisht**

Kjo lëndë ka për qëllim t'i njoftojë studentët me konceptet themelore nga fusha e përkthimit. Fokusi kryesor i kësaj lënde është përkthimi i teksteve nga gjuha shqipe respektivisht maqedonase në gjermanisht. Kjo formë e përkthimit përfshinë përkthimin e teksteve letrare, siç janë: tregimet, novelat, romanet, poezitë, etj. Gjithashtu, do të përkthehen edhe shkrime nga gazetatat dhe revistat.

- **Sintaksa e gjuhës gjermane**

Lënda ka për qëllim t'i njoftojë studentët me konceptet themelore të sintaksës së gjuhës gjermane. Në plan të parë të kësaj ligjërate para së gjithash qëndron struktura e fjalisë gjermane. Në kuadër të lëndës, në radhë të parë, do të trajtohen këto tema: konceptet themelore të sintaksës së gjuhës gjermane; çka është fjalia? Shembuj nga analiza e përbërjes së fjalisë, llojet e fjalisë, fjalia e thjeshtë, fjalia e përbërë, Angauesätze, Attributsätze, Wortstellung, Grammatische Kongruenz und Satzfeld und Satzklammer, problemet e teorisë së valencës, dallimet në mes Ergänzungen dhe Angaben, modele të fjalisë, valenca e emrave dhe mbiemrave, modele të ndryshme gramatikore. Në fund të semestrit, studentët, jo vetëm që do të duhet t'i dinë nocionet më të rëndësishme të sintaksës dhe valencës gramatikore, por edhe t'i zbatojnë, analizojnë dhe t'i përdorin si duhet.

- **Gjuhë e sotme gjermane IV**

Qëllimi i kësaj lënde, para së gjithash, është përfitimi i kompetencave gjuhësore në nivel B1/2. Në kuadër të lëndës do të thellohen njohuritë paraprake të shkathtësive gjuhësore: të dëgjuarit, të kuptuarit, të lexuarit dhe të folurit përmes punës me librin "Schritte international 5". Biseda në tema nga jeta e përditshme, dialog, kompozime të shkurtra, tekste të thjeshta nga gazetatat, tekste me zbrazëtira, ushtrime fonetike, ushtrime për të kuptuar tekstin e folur, etj. Gjithashtu, do të punohet në thellimin e njohurive nga strukturat komplekse gramatikore të gjuhës gjermane.

- **Letërsia gjermane e shek. 20 (1900-1945)**

Kjo lëndë ka për qëllim të ofrojë qasje në historinë e letërsisë gjermane të shekullit 20. Nga studentët pritet njohje me veprat dhe autorët më të dalluar të kësaj periudhe me qëllim të kuptimit të mënyrës së të menduarit dhe të krijimit të letërsisë gjermane të shekullit 20. Lënda duhet t'i aftësojë studentët të depërtojnë në interpretimin e teksteve të ndryshme të kësaj periudhe dhe në krijimin e teksteve të shkruara. Me këtë lëndë studentët do të njihen me veprat dhe autorët letrar, si dhe me zhanret e letërsisë gjermane të shekullit 20, siç janë: periudha e ekspresionizmit, ekzili, etj.

- **Gjuhë e sotme gjermane V**

Qëllimi i kësaj lënde, para së gjithash, është përfitimi i kompetencave gjuhësore në nivelin B2/1. Lënda është vazhdimësi e gjuhës gjermane 4. Njohuritë, duhet gradualisht të zgjerohen edhe atë më së tepërmi në gramatikën dhe bisedën në gjuhën gjermane. Bisedat dhe diskutimet nga materialet e lexuara me temat aktuale janë shumë të rëndësishme. Në fund të lëndës duhet të jenë në gjendje të formulojnë dhe kuptojnë fjali më të përbërë. Shkathtësitë gjuhësore, duhet edhe më tej të përmirësohen, veçanërisht të folurit e fjalive të përbërë dhe komplekse. Për tema të ndryshme bëhen ushtrime përkatëse dhe si rrjedhojë pasurohet fjalori.

- **Leksikologjia e gjuhës gjermane**

Qëllimi i kësaj lënde është njohja e studentëve me bazat e leksikologjisë dhe leksikografisë gjermane. Në fokus të kësaj ligjërate qëndrojnë konceptet fillestare të leksikologjisë, fjalëformimi, onomastika, leksikografia etj. Në kuadër të kësaj lënde janë përfshirë temat: lënda, detyra dhe etiketimin e leksikologjisë; pozita e leksikologjisë në sistemin e disiplinave gjuhësore; fjala si njësi gjuhësore; shkenca për fjalëformimin; komponimi; derivimi; shkenca mbi kuptimin e fjalës; struktura e fjalorit, zhvillimi i fjalorit; onomastika; frazeologjia dhe leksikografia.

- **Metodologjia e mësimdhënies së gjermanishtes si gjuhë e huaj I**

Lënda ka për qëllim të japë një pasqyrë të metodologjisë së mësimdhënies së gjuhës gjermane dhe të lidhjeve të saj me disiplinat e ngjashme. Një pasqyrë të metodave të gjuhëve të huaja: gramatikore-përkthyes, të drejtpërdrejtë, audio-vizuale, audio-gjuhësore, metoda kognitive dhe qasje komunikuese me koncept pragmatik-funksional dhe ndërkulturore. Metodatat alternative. Gjermanistika interkulturore. Faktorët e ligjëratës. Parimet pedagogjike. Parimet metodologjike-didaktike. Teoritë e mësimdhënies. Strategjitë e mësimdhënies. Personaliteti i mësimdhënësit. Format sociale. Format punuese. Kompetencat komunikuese dhe shkathtësitë gjuhësore: dëgjim me kuptim, të folurit, shkrim dhe lexim. Vlerësimi. Testet. Testet e standardizuara. Korniza evropiane referuese e përbashkët dhe portofoli gjuhësor.

- **Gjuhë e sotme gjermane VI**

Qëllimi i kësaj lënde, para së gjithash, është përfitimi i kompetencave gjuhësore në nivelin B2/2. Lënda është

vazhdimësi e gjuhës gjermane 5. Gjithashtu, do të përfitohen shkathtësitë gjuhësore: të dëgjuarit, të kuptuarit, të lexuarit dhe bisedë përmes punës me librin "Ziel Kursbuch B2/2". Në bazë të teksteve aktuale autentike e video prezantimeve, studentët, do të ushtrojnë në praktikë dialogun dhe monologun, reagimin e përshtatshëm spontan gjatë diskutimit. Gjithashtu, do të ushtrohen format e refuzimit, miratimit dhe përgjigjes gjatë shprehjes së mendimeve dhe propozimeve, etj.

- **Metodologjia e mësimdhënies së gjermanishtes si gjuhë e huaj II**

Kjo lëndë ka për qëllim të japë një vështrim në metodologjinë e mësimdhënies së gjuhës gjermane si gjuhë e huaj: llojet e orëve mësimore, planifikimin, realizimin dhe vlerësimin. Qëllimet e klasës. Ora mësimore. Zgjedhje, gradim dhe prezantim i materialit. Progres gramatikor. Zgjedhje dhe progres në temat dhe leksikun. Mediume dhe mjete ndihmëse në mësim. Në kuadër të kësaj lënde janë paraparë 10 orë hospitime nga gjuha gjermane në shkollat fillore, të mesme, gjimnazet, ose institucione tjera arsimore. Secili student gjatë këtij semestri duhet në mënyrë të pavarur të mbaje 3-4 model-orë dhe një orë praktike (provim). Gjatë këtyre orëve, duhet të zbatohen të gjitha njohuritë teorike dhe praktike, të cilat janë përvetësuar gjatë semestrave paraprak.

- **Gramatika dhe mësimdhënia e gramatikës**

Kjo lëndë ka për qëllim t'i njoftojë studentët me karakteristikat më të rëndësishme gramatikore të gjuhës gjermane, veçanërisht në fushën e morfologjisë dhe sintaksës së gjuhës gjermane. Këto njohuri janë thelbësore për mësuesit e gjermanishtes si gjuhë e huaj, të cilët ndeshen dhe përballen me pyetjet për zbatimin e analizave specifike të këtyre fenomene gramatikore dhe didaktizimin e tyre konkret.

- **Kompetenca receptive dhe produktive e tekstit I**

Qëllimi i lëndës është të zhvillojë kompetencën receptive dhe produktive në të shprehurit me gojë dhe me shkrim. Zgjerimi dhe konsolidimi i kompetencës morfologjike, sintaksore, semantike dhe stilistike me qëllim të zhvillimit të aftësive përkthyes. Gjithashtu, qëllimi i kësaj lënde është zotërimi i kompetencave gjuhësore në nivelin C1 / 1.

- **Fjalëformimi i gjuhës gjermane**

Qëllimi i lëndës është njohja e studentëve me nocionet themelore të fjalëformimit të gjermanishtes. Në plan të parë të kësaj ligjërate, para së gjithash, do të trajtohen këto tema: kuptimi, lënda, detyrat dhe metodat. Teoritë fjalëformuese: Vendi i fjalëformimit në gramatikë, Fillet e fjalëformimit në gjuhën gjermane. Njësitë fjalëformuese, proceset dhe llojet. Modelet fjalëformuese të emrave kompleks gjermanë, të foljeve, mbiemrave dhe ndajfoljeve kundrejt atyre shqipe dhe maqedonase; modelet aktive dhe joaktive, fjalë leksiku dhe tekstuale (okazionalizma).

- **Linguistika kontrastive**

Kjo lëndë ka për qëllim të njoftojë studentët me konceptet më të rëndësishme të linguistikës kontrastive. Linguistika Kontrastive merret me ngjashmëritë dhe dallimet midis gjuhëve të ndryshme (perspektiva interlinguale) dhe brenda një gjuhe (perspektiva intralinguale, për shembull: aspektet e gjuhës gjermane në Gjermani, Austri dhe Zvicër). Parimisht, mund të paraqiten çfarëdo lloj çiftesh gjuhësore dhe karakteristika nga të gjitha fushat e strukturës gjuhësore (fonologji, morfologji, sintaksë, pragmatikë, leksik, etj.). Leksioni jep një pasqyrë të fazave të ndryshme dhe fushave kërkimore të linguistikës kontrastive dhe kjo lidhet me një reflektim kritik mbi rolin e saj në didaktikën e gjuhësore. Pastaj, çiftet gjuhësore, si për shembull gjermanisht-shqip dhe gjermanisht-maqedonisht përmes shembujve, do të krahasohen strukturat më të rëndësishme fonetike, morfologjike, sintaktiksore dhe pragmatike. Përveç kësaj, do të diskutohet edhe për aplikimin e njohurive të fituara në çështjet e linguistikës së përgjithshme, teorisë së mësimin të gjuhës dhe të didaktikës. Lënda i plotëson dhe thellon njohuritë bazë në këtë fushë.

- **Kompetenca receptive dhe produktive e tekstit II**

Qëllimi i lëndës është të zhvillojë kompetencën receptive dhe produktive në të shprehurit me gojë dhe me shkrim. Zgjerimi dhe konsolidimi i kompetencës morfologjike, sintaksore, semantike dhe stilistike me qëllim të zhvillimit të aftësive përkthyes. Gjithashtu, qëllimi i lëndës është zotërimi i kompetencave gjuhësore në nivelin C1 / 2.

- **Historia e gjuhës gjermane**

Qëllimi i lëndës është t'i njoftojë studentët me nocionet themelore dhe rrjedhat e indo-gjermanishtes dhe gjermanishtes. Gotishtja, si reprezentant i paragjuhës gjermane. Zhvendosja e parë e bashkëtingëlloreve. Theksi. Ligji i Vernerit. Zanoret. Ablaut. Zgjedhimi i foljes. Ndarja e emrave. Ndryshimi i mbiemrave. Specifikat (zhvendosja e dytë e bashkëtingëlloreve, harmonia e zanoreve: umlaut primar, kalimi i e në i; . kalim i i në e dhe i u në o, etj). Përpunimi i këngës për Hildebrand. Specifikat (dobësim i zanoreve në rrokje të patheksuar, umlaut dytësor, kalim të sk në sch etj). Përpunimi i këngës për Niuelungët. Specifikat (diftongizim, monoftongizim vazhdim, shkurtim, lëshim, ngritje të zanoreve etj). Veprimtaria e Luterit.

- **Teoria dhe praktika e mësimdhënies së gjermanishtes si gjuhë e huaj**

Qëllimi i lëndës është t'i njohë studentët me konceptet më të rëndësishme dhe modelet e metodologjisë dhe të didaktikës së mësimdhënies së gjermanishtes si gjuhë e huaj në nivel universitar. Gjithashtu, do të lexohen dhe do të diskutohen debatet më të rëndësishme dhe më aktuale metodologjike-didaktike. Në fund të semestrit studentët, do jenë të aftë: - Të demonstrojnë një njohuri të gjerë dhe të kuptuarit e zhvillimit dhe trendeve aktuale në metodologjinë e mësimdhënies së gjermanishtes si gjuhë e huaj, gjegjësisht lidhjen dhe integrimin e përmbajtjeve kompatible nga lëndët mësimore: gjuhë, linguistikë, kulturologji, letërsi dhe përmbajtje tjera mësimore kompatible më pak të rëndësishme. - Të jenë në gjendje të aplikojnë njohuritë dhe të kuptuarit e tyre në veprimtarinë e tyre, ose profesionin e tyre si mësues të gjuhës gjermane, duke e përpunuar dhe duke e zhvilluar zgjidhjen e problemeve dhe argumenteve në metodologjinë e mësimdhënies së gjermanishtes si gjuhë e huaj. - Të mbledhin, të vlerësojnë dhe të interpretojnë të dhënat relevante dhe informatat brenda kësaj fushe. - Të jenë në gjendje të diskutojnë për informacionet, problemet dhe zgjidhjet e ndryshme, veçanërisht në këtë fushë. - Të zhvillojnë aftësitë e të mësuarit, të cilat u nevojiten për të vazhduar shkollimin e tyre të mëtejshëm.

Lëndë zgjedhore

- **Gjuhë shqipe për fillestarë 1**

Lënda Gjuhë Shqipe për Fillestarë 1 dhe 2, është e përgatitur me qëllim që studentëve, të cilët nuk kanë njohuri themelore mbi gjuhën shqipe, t'u mundësojë të njihen me karakteristikat (veçoritë) e kësaj gjuhe, të fitojnë njohuri mbi strukturën gjuhësore të kësaj gjuhe, t'i zgjerojnë dhe t'i përdorin njohuritë e tyre në situata të përditshme, me ndihmën e të cilave në të njëjtën kohë, do të fitojnë njohuri mbi strukturën e gjuhës. Gjithashtu, do të jenë të aftë të fitojnë një fond modest të kategorive të ndryshme leksikore-gramatikore, të cilat do t'u mundësojnë biseda (konverzacione), të thjeshta.

- **Gjuhë shqipe për fillestarë 2**

Lënda Gjuhë Shqipe për Fillestarë 1 dhe 2, është e përgatitur me qëllim që studentëve, të cilët nuk kanë njohuri themelore mbi gjuhën shqipe, t'u mundësojë të njihen me karakteristikat (veçoritë) e kësaj gjuhe, të fitojnë njohuri mbi strukturën gjuhësore të kësaj gjuhe, t'i zgjerojnë dhe t'i përdorin njohuritë e tyre në situata të përditshme, me ndihmën e të cilave në të njëjtën kohë, do të fitojnë njohuri mbi strukturën e gjuhës. Gjithashtu, do të jenë të aftë të fitojnë një fond modest të kategorive të ndryshme leksikore-gramatikore, të cilat do t'u mundësojnë biseda (konverzacione), të thjeshta.

- **Gjuhë maqedonase për fillestarë 1**

Programi për Gjuhën Maqedonase për Fillestarë 1, përfshinë: të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe të folurit. Përmes ushtrimeve të veçanta dhe ligjëratave u mundësohet studentëve ta njohin komunukimin bazë në gjuhën maqedonase, d.m.th, të njoftuarit, përshëndetjet, prezantimin, si dhe pasurimin e fondit të fjalëve bashkë me të shkruarit dhe të kuptuarit të teksteve të vogla. Në përpilimin e programit është marrë parasysh që njohuritë e fituara nga ana e studentëve të mund të zbatohen edhe mëtutje. Materiali përpunohet sipas parimit të ligjëratave dhe ushtrimeve të kombinuara, si dhe detyrave të vazhdueshme përmes, të cilave studentët përfshihen në mënyrë aktive gjatë orës mësimore duke parashtruar pyetje dhe propozime për mbarëvajtjen e orës.

- **Gjuhë maqedonase për fillestarë 2**

Lënda Gjuhë Maqedonase për Fillestarë 2, përfshinë: të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit dhe të folurit. Në suaza të kësaj lënde përfshihen gjerat në vijim: detyra të përditshme, plainifikimi i aktiviteteve për periudhën e ardhshme, përshkrimi i personave, vendeve dhe lëndëve. Në përpilimin e programit është marrë parasysh, që njohuritë e fituara nga ana e studentëve të mund të zbatohen edhe mëtutje.

- **Gjuhë maqedonase niveli i mesëm 1**

Lënda Gjuhë Maqedonase - Niveli i Mesëm 1, përfshin: leximin, shkrimin, dëgjimin dhe të folurit nëpërmjet të cilit studentët: do të pasurojnë fjalorin përmes teksteve të përshtatshme për aktivitetet e përditshme (në një bankë, në bibliotekë, në ministri, etj.) dhe do të përmirësojnë shkathtësitë për shkrimin profesional dhe të folurit që janë të nevojshme për komunikim të qartë dhe efektiv në karrierën e tyre të mëtejshme profesionale. Një theks i veçantë dhe i vazhdueshëm mbi aktivitetin e përgjithshëm është vendosur në elementet gjuhësorë, domethënë në drejtshkrimin dhe gramatikën e gjuhës standarde maqedonase. Ekspertët, si një nga elementët kyç për shprehjen e mirë me shkrim e përcaktojnë përdorimin korrekt të gjuhës.

- **Gjuhë maqedonase niveli i mesëm 2**

Lënda Gjuhë Maqedonase - Niveli i Mesëm 2, përfshin: leximin, shkrimin, dëgjimin dhe të folurit. Theks i veçantë vihet në zhvillimin e aftësive të komunikimit të studentëve, ose përdorimin e gjuhës në aktivitetet e përditshme dhe

kontekstin profesional, duke pasuruar fjalorin dhe duke fituar njohuri për strukturën dhe llojet e teksteve profesionale. Do të përshihen stile të ndryshme të komunikimit, me qëllim që studentët të krijojnë komunikim të mirë me publikun përmes teksteve të tyre dhe të tërheqin dhe mbajnë vëmendjen e tyre.

- **Gjuhë maqedonase për qëllime profesionale 1**

Pas përfundimit të lëndës Gjuhë Maqedonase për Qëllime Profesionale 1, nga studentët pritet t'i zgjerojnë dhe t'i forcojnë aftësitë e tyre për shprehje më të avancuar me shkrim dhe me gojë në maqedonisht në kontekstin e mjedisëve të ndryshme profesionale. Studentët, pritet të jenë në gjendje të lexojnë, të shkruajnë dhe të kuptojnë tekste të ndryshme profesionale në maqedonisht. Ata, gjithashtu pritet të fitojnë njohuri dhe aftësi në lidhje me terminologjinë e përgjithshme nga fusha e drejtësisë, biznesit dhe ekonomisë, administratës, shkencave kompjuterike, gjuhës dhe komunikimit dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë terminologji në korniza të profesioneve të tyre të ardhshme. Përveç përmblotjes së këtyre qëllimeve profesionale, studentët pritet të bëhen më autonomë në mësimin e gjuhës dhe të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike në një ambient shumëgjuhësor dhe shumëkulturore.

- **Gjuhë maqedonase për qëllime profesionale 2**

Pas përfundimit të lëndës Gjuhë Maqedonase për Qëllime Profesionale 2, nga studentët pritet t'i rikonfirmojnë dhe t'i zgjerojnë më tej aftësitë e tyre për shprehje të avancuar me shkrim dhe me gojë në maqedonisht në kontekstin e profesioneve të tyre të ardhshme. Ata, do të jenë në gjendje të lexojnë, shkruajnë dhe të kuptojnë lloje të ndryshme të teksteve profesionale në maqedonisht, të analizojnë dhe t'i diskutojnë këto tekste, si dhe t'i krijojnë dokumentet e tyre, duke përfshirë biografi profesionale në maqedonisht (CV). Ata, gjithashtu duhet t'i zgjerojnë njohuritë e terminologjisë specifike nga fusha e drejtësisë, biznesit dhe ekonomisë, administratës, shkencave kompjuterike, gjuhëve dhe komunikimit dhe të jenë në gjendje ta përdorin atë terminologji në simulimin e situatave autentike nga mjediset profesionale në debate dhe në shkëmbim mendimesh në lidhje me aspektet e ndryshme të këtyre profesioneve.

- **Gjuhë angleze 1**

Pas përfundimit të secilit nivel të kësaj lënde që përcaktohet sipas testit për përcaktim të nivelit në fillim të semestrit/vitit, prej studenëve pritet të jenë në nivel të ndryshëm sipas kornizës gjuhësore Evropiane dhe të mund të kuptojnë dhe përdorin fraza dhe shprehje të ndryshme për nevojat e tyre siç janë: pyetje dhe përgjigje për veten dhe familjen, për jetën e tyre, për kohën e lirë, financa, për diploma universitare, për shkathtësi të punës, për avansimin e tyre personal, për profesionin e tyre të ardhshëm dhe të ngjashme, të marrin pjesë në dialogje dhe debate dhe të shkruajnë paragrafe apo ese për tema që i kanë përpunuar. Pas përfundimit të kursit, prej studentëve pritet të jenë në nivelin A1 sipas kornizës gjuhësore Evropiane. Ata duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe përdorin në mënyrë të drejtë shprehjet themelore në lidhje me kërkesat konkrete, të pyesin dhe përgjigjen në lidhje me pyetjet për identitetin personal dhe marrëdhëniet, të prezantojnë veten dhe të tjerët duke përdorur përemrat vektorë dhe pronorë, të përshëndeten, të përdorin fjalor të saktë për objektet në klasë, të bëjnë dallim në mes të njëjësit dhe shumës, të njohin dhe të përdorin numrat prej 1- 100. Gjithashtu, studentët duhet të jenë në gjendje të përshkruajnë një ditë të zakonshme me përdorim të strukturave më të thjeshta gjuhësore, të shkruajnë dhe të flasin për jetën e tyre dhe kohën e lirë. Ata duhet të njohin dhe përdorin në mënyrë të drejtë fjalorin në lidhje me kategoritë e ushqimeve dhe pijeve, muajt e vitit, të bëjnë kërkesa në mënyrë të sjellshme, të përshkruajnë vende, të zgjedhin një destinacion dhe të japin udhëzime, të flasin për gjërat që u pëlqejnë dhe nuk u pëlqejnë.

- **Gjuhë angleze 2**

Pas përfundimit të secilit nivel të kësaj lënde që përcaktohet sipas testit për përcaktim të nivelit në fillim të semestrit/vitit, prej studenëve pritet të jenë në nivel të ndryshëm sipas kornizës gjuhësore Evropiane dhe të mund të kuptojnë dhe përdorin fraza dhe shprehje të ndryshme për nevojat e tyre siç janë: pyetje dhe përgjigje për veten dhe familjen, për jetën e tyre, për kohën e lirë, financa, për diploma universitare, për shkathtësi pune, për avansimet e tyre personale, për profesionin e tyre të ardhshëm dhe të ngjashme, të marrin pjesë në dialogje dhe debate dhe të shkruajnë paragrafe ose ese për tema që i kanë përpunuar. Pas përfundimit të kursit prej studentëve pritet të jenë në nivelin A1 sipas kornizës gjuhësore Evropiane. Ata duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe përdorin në mënyrë të drejtë shprehjet themelore në lidhje me kërkesat konkrete, të pyesin dhe përgjigjen në lidhje me pyetjet për identitetin personal dhe marrëdhëniet, të prezantojnë veten dhe të tjerët duke përdorur përemrat vektorë dhe pronorë, të përshëndeten, të përdorin fjalor të saktë për objektet në klasë, të bëjnë dallim në mes të njëjësit dhe shumës, të njohin dhe të përdorin numrat prej 1- 100. Gjithashtu, studentët duhet të jenë në gjendje të përshkruajnë një ditë të zakonshme me përdorim të strukturave më të thjeshta gjuhësore, të shkruajnë dhe të flasin për jetën e tyre dhe kohën e lirë. Ata duhet të njohin dhe përdorin në mënyrë të drejtë fjalorin në lidhje me kategoritë e ushqimeve dhe pijeve, muajt e vitit, të bëjnë kërkesa në mënyrë të sjellshme, të përshkruajnë vende, të zgjedhin një destinacion dhe të japin udhëzime, të flasin për gjërat që u pëlqejnë dhe nuk u pëlqejnë.

• Gjuhë angleze 3

Pas përfundimit të secilit nivel të kësaj lënde që përcaktohet sipas testit për përcaktim të nivelit në fillim të semestrit/vitit, prej studentëve pritet të jenë në nivel të ndryshëm sipas kornizës gjuhësore Evropiane dhe duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe përdorin shprehje dhe fraza të njohura që kanë për qëllim përmbytjen e nevojave të një tipi real: të pyesin dhe tu përgjigjen pyetjeve për fenomene të ndryshme duke përfshirë krimin dhe katastrofat natyrore, të ftojnë dhe tu përgjigjen ftesave, të lexojnë dhe dëgjojnë thelbin, detajin dhe të kuptojnë, të vlerësojnë përparimin e tyre personal, të marrin pjesë në role dhe dialogje për tema të njohura dhe të prodhojnë një paragraf/ese për temat në lidhje me temat e materialit të lëndës. Në fund të këtij kursi studentët pritet të jenë në nivelin B1 të kornizës së përbashkët Evropiane. Ata duhet të jenë në gjendje të pyesin pyetje dhe të përgjigjen për gradat universitare, shkathtësitë e punës dhe situatat, të ftojnë dhe tu përgjigjen ftesave. Studentët duhet të jenë në gjendje të pyesin dhe të përshkruajnë marrëdhëniet familjare dhe gjendjen martesore dhe duhet të jenë në gjendje të njohin dhe përdorin në mënyrë të përshtatshme fjalorin në lidhje me gradat universitare dhe arsimin universitar, artin, udhëtimin dhe sportin.

• Gjuhë angleze 4

Pas përfundimit të secilit nivel të kësaj lënde që përcaktohet sipas testit për përcaktim të nivelit në fillim të semestrit/vitit, prej studentëve pritet të jenë në nivel të ndryshëm sipas kornizës gjuhësore Evropiane dhe duhet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe përdorin shprehje dhe fraza të njohura që kanë për qëllim përmbytjen e nevojave të një tipi real; të pyesin dhe të japin përgjigje për identifikim personal dhe marrëdhënie personale; të flasin dhe shkruajnë për jetën e tyre të përditshme, kohën e lirë, argëtimin, mjedisin e financave, problemet; të jenë në gjendje të pyesin pyetje dhe të përgjigjen për gradat universitare, shkathtësitë e punës dhe situatat. Pas përfundimit të këtij kursi studentët pritet të jenë në nivelin B2 të kornizës së përbashkët Evropiane; Ata pritet të jenë përdorues të pavarur të gjuhës angleze dhe të munden të zbatojnë disa nga funksionet gjuhësore të mëposhtme: të japin këshilla; të pyesin pyetje dhe të përgjigjen për gradat universitare, shkathtësitë e punës dhe situatat; të ftojnë dhe tu përgjigjen ftesave, të lexojnë dhe dëgjojnë thelbin, detajin dhe të kuptojnë.

• Gjuhë angleze 5

Gjuha angleze për qëllime akademike është lëndë me kohëzgjatje prej një semestri. Qëllimet e lëndës janë t'u mundësojë studentëve të fitojnë aftësi të cilat do u ndihmojnë mësimnxënien e tyre gjuhësore dhe përparimin e tyre gjuhësor në një mjedis akademik të mësimnxënies dhe mësimdhënies. Kursi duhet ti aftësojë të përdorin këta aftësi edhe në orë të gjuhës së huaj si edhe në përparimin akademik në fushat e përmbytjes. Kursi përfshin aftësi gjuhësore, studiuese dhe në përgjithësi aftësi zbatuese (dëgjim, dhënie të prezantimeve me gojë, argumente konstruktive) në detyra të veçanta. Për këtë arsye, pas përfundimit të suksesshëm të kursit, niveli i zotësisë së gjuhës duhet të jetë në nivelin C1 sipas kornizës së përbashkët Evropiane. Si rezultat, studentët duhet të jenë në gjendje të prezantojnë në mënyrë të suksesshme prezantime orale, të marrin pjesë në tribuna të debateve/diskutimeve online duke shprehur mendimet dhe argumentet e tyre dhe tu japin të tjerëve informacion kthyes në mënyrë konstruktive. Përveç kësaj, studentët duhet të jenë në gjendje të dëgjojnë dhe lexojnë thelbin dhe të shkruajnë një paragraf dhe ese argumentues duke shprehur mendimet e tyre. Ata duhet të shkruajnë një paragraf dhe ese që zgjidh problemin. Ata duhet të jenë në gjendje të prezantojnë informacion pamor në formën e prezantimit poster në Power Point. Studentët duhet të jenë në gjendje të identifikojnë idetë kryesore dhe faktet mbështetëse në një tekst dhe të analizojnë dhe identifikojnë fjalinë kryesore të temës në një paragraf. Ata duhet të jenë në gjendje të identifikojnë qëllimin e një teksti, modelet e organizimit në një tekst dhe të zbatojnë ata në shkrimet e tyre.

• Anglishtja për shkencë shoqërore 1

Kjo lëndë ofrohet me qëllim të përmirësimit të katër aftësive kryesore të gjuhës, siç janë leximi, shkrimi, dëgjimi dhe të folurit në fushën specifike të përmbytjes, si dhe rishikimi dhe avancimi i artikujve dhe fjalorit të përzgjedhur në nivel të mesëm dhe të mesëm të lartë në fushën e shkencave shoqërore. Kjo është bërë për t'u mundësuar studentëve të kuptojnë tekste më të komplikuar në fushën e përmendur dhe t'u mundësojnë atyre të komunikojnë me rrjedhshmëri me kolegë dhe ekspertë në fushën e shkencave shoqërore. Kjo lëndë fokusohet në zhvillimin e njohurive gjuhësore në fjalorin e përgjithshëm dhe në lëndët, zhvillimin e aftësive akademike të shkrimit dhe leximit dhe diskutimin e artikujve nga fushat e Politikës Publike, Shkencave Politike dhe Komunikimit Ndërkombëtar, si pjesë e aftësive të tyre të të folurit. Fokusi kryesor është përdorimi i fjalorit profesional të lidhur me komunikimin dhe zhvillimin e karrierës së ardhshme të studentëve.

• Anglishtja për shkencë shoqërore 2

Kjo lëndë ofrohet me qëllim të përmirësimit të katër aftësive kryesore të gjuhës, siç janë leximi, shkrimi, dëgjimi dhe të folurit në fushën specifike të përmbytjes, si dhe rishikimi dhe avancimi i artikujve dhe fjalorit të përzgjedhur në nivel të mesëm dhe të mesëm të lartë në fushën e shkencave shoqërore. Kjo është bërë për t'u mundësuar studentëve të kuptojnë tekste më të komplikuar në fushën e përmendur dhe t'u mundësojnë atyre të komunikojnë me rrjedhshmëri me kolegë dhe ekspertë në fushën e shkencave shoqërore. Kjo lëndë fokusohet në zhvillimin e

njohurive gjuhësore në fjalorin e përgjithshëm dhe në lëndët, zhvillimin e aftësive akademike të shkrimit dhe leximit dhe diskutimin e artikujve nga fushat e Politikës Publike, Shkencave Politike dhe Komunikimit Ndërkombëtar, si pjesë e aftësive të tyre të folurit. Fokusi kryesor është përdorimi i fjalorit profesional të lidhur me komunikimin dhe zhvillimin e karrierës së ardhshme të studentëve.

- **Kapituj të zgjedhur nga shkathtësitë e TI**

Qëllimi i kësaj lënde është: - T'ua tregojë studentëve elementet teknike, strukturën e tekstit dhe dizajnin e punimeve të ndryshme gjatë studimeve. - T'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri mbi shkathtësitë e TI, që do t'u duhen për përpunimin e punimeve shkencore, profesionale dhe prezantime. - Të aftësojë studentët për zbatimin praktik të shkathtësive të TI.

- **Microsoft Office Access**

Kursi Zyrtar Akademik i Microsoft (MOAC) për Aksesin 2016, ofron përvojën praktike për të rritur aftësitë tuaja personale të produktivitetit. Ky program, i ndarë në 15 mësimë, mbulon të gjitha fushat e produktit që kërkohet për të kaluar provimin MOS 77-730.

- **Microsoft Office Excel**

Kursi Zyrtar Akademik i Microsoft (MOAC) për Excel 2016, ofron përvojën praktike për të rritur aftësitë tuaja personale të produktivitetit. Ky program, i ndarë në 13 mësimë, mbulon të gjitha fushat e produktit që kërkohet për të kaluar provimin MOS 77-727

- **Microsoft Office PowerPoint**

Kursi Zyrtar Akademik i Microsoft (MOAC) për PowerPoint 2016, ofron përvojën praktike për të rritur aftësitë tuaja personale të produktivitetit. Ky program, është i ndarë në 11 burime mësimore dhe mbulon të gjitha fushat e produktit të kërkuara për të kaluar provimin MOS 77-729.

- **Microsoft Office Word**

Kursi Zyrtar Akademik i Microsoft (MOAC) për Word 2016, ofron përvojën praktike për të rritur aftësitë tuaja personale të produktivitetit. Ky program është i ndarë në 11 burime mësimore dhe mbulon të gjitha fushat e produktit të kërkuara për të kaluar provimin MOS 77-725.

- **Krijimi i ueb-it**

Kursi Zyrtar Akademik i Microsoft (MOAC) për PowerPoint 2016, ofron përvojën praktike për të rritur aftësitë tuaja personale të produktivitetit. Ky program, është i ndarë në 11 burime mësimore dhe mbulon të gjitha fushat e produktit të kërkuara për të kaluar provimin MOS 77-729.

- **Dizajnimi i medimeve digjitale**

Qëllimi i lëndës është të dizajnojë dhe përpunojë grafika raster dhe vektoriale përmes programeve kryesore, siç janë Adobe Photoshop dhe Illustrator, si dhe projektimin dhe botimin e materialeve komerciale për shtyp, duke përdorur Adobe In Design

- **Google aplikacione për edukim**

Përmbledhje konceptuale me udhëzime praktike për shfrytëzimin e potencialit arsimor të G Suite. Kjo i identifikon parimet e të mësuarit që e mundësojnë përdorimin efektiv të G Suite për të krijuar mjedise mësimore që rrisin komunikimin arsimor. Lënda është e organizuar në një seri modulesh. Modulet janë të bashkangjitur në një meni përmbledhëse, të cilat mund të qasen në faqen "Google" për edukim, e cila i organizon modulet me po të njëjtën radhitje me të cilën do të diskutohen në klasë.

- **Hyrje në administrimin publik**

Administrata publike paraqet një fushë të veçantë me interes shkencor. Lënda: Hyrje në Administrimin Publik duhet t'u ofrojë studentëve njohuri mbi konceptet themelore të administratës publike. Kujdes i posaçëm do t'i kushtohet ofrimit të njohurive për evoluimin e administratës publike, si dhe të reformave të parapara të administratës publike në vendin tonë. Gjithashtu, studentët, do të kenë mundësi të njoftohen dhe në mënyrë kritike t'i analizojnë zhvillimin dhe fenomenet në administratën publike. Meqë lëmi i studimit është objekt i ndryshimit të pandërprerë, kujdes i veçantë do t'u kushtohet zhvillimeve të reja, si dhe teorive klasike të studimit të administratës publike. Materia hulumtuese e kësaj lënde konsiston në: përkufizimet dhe njohuritë themelore për parimet dhe institucionet e administratës publike,

rolin dhe rëndësinë e administratës publike në shoqërinë e organizuar, gjenezën dhe zhvillimin historik të administratës publike, strukturat organizative të administratës publike, funksionimin e institucioneve të administratës publike, shërbimet e administratës publike, vendimarrjen në AP.

- **Lidershipi publik dhe zhvillimi organizativ**

Kjo lëndë ka për qëllim t'i njoftojë studentët me mënyrën se si liderët dhe udhëheqësit i zhvillojnë dhe si i zbatojnë arritjet e misionit dhe vizionit në një organizatë të dhënë në sektorin publik; zhvillimin e vlerave të nevojshme për sukses afatgjatë dhe zbatimin e tyre nëpërmjet aktiviteteve dhe shprehive të përshtatshme; si liderët dhe udhëheqësit janë personalisht të përfshirë në sigurimin, që sistemet e menaxhimit të sigurisë, do të zhvillohen dhe zbatohen. Gjithashtu, i njofton për mënyrën se si organizata e realizon misionin dhe vizionin e saj përmes një strategjie të qartë të bazuar në pikëpamjet e të gjitha palëve të interesuara, të mbështetur nga të gjitha politikat relevante, planet, qëllimet dhe proceset.

- **Hyrje në politikat publike**

Lënda ka për qëllim t'u mundësojë studentëve që t'i kuptojnë më lehtë politikat publike, parimet për krijimin e tyre, udhëheqjen e një politike konkrete, analizën, implementimin, vlerësimin dhe zhvillimin e saj. Menaxhimi i politikave publike është disiplinë për zgjidhjen e problemeve, të cilat rezultojnë në njohuri nga metodologjitë dhe teoritë themelore të shkencave sociale, të profesioneve sociale dhe të filozofisë së politikave.

- **Liritë dhe të drejtat e njeriut**

Lufta për të drejtat e njeriut fillon me përpjekjet historike për t'i identifikuar ato. Me kalimin e kohës, korpusi i të drejtave dhe lirive të njeriut që mbrohen me ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare është zgjeruar, por kjo nuk do të thotë se ato respektohen në praktikë. Në fillim, të drejtat e njeriut konsideroheshin si çështje të brendshme të shteteve (sipas parimit të sovranitetit absolut të shtetit) dhe vetëm në kohërat më të reja ato fituan statusin e normave kogente. Kjo lëndë e studion zhvillimin e doktrinës për të drejtat e njeriut, llojet dhe kategoritë e të drejtave të njeriut dhe dokumentet kryesore që i rregullojnë dhe që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut. Kjo lëndë ka për qëllim: t'i njoftojë studentët me konceptin e të drejtave ndërkombëtare të njeriut, me zbatimin e tyre dhe me ndikimin që ato kanë në formulimin e politikave kombëtare. Kjo do t'i inkurajojë studentët të reflektojnë në mënyrë kritike mbi raportin mes të drejtës ndërkombëtare dhe të asaj kombëtare, do t'i vetëdijësojë ata për ndryshimet ndërkombëtare në këtë drejtim dhe për mënyrën se si këto të drejta ndikojnë në jetën e njerëzve në botë. Lënda do t'i nxisë që të kontributojnë në përparimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

- **Shkrimi dhe arsyetimi ligjor**

Qëllimi i lëndës është që studentëve t'u ofrojë njohuritë themelore të shkrimit dhe arsyetimit juridik. Në këtë lëndë, do të përfitojnë njohuritë e shkrimit dhe arsyetimit juridik, parimet dhe udhëzimet themelore për të, duke zbatuar metodat e ndryshme të shkrimit juridik të akteve juridike normative (rregulloret, ligjet, vendimet, aktgjykimet, kontratat, testamentet, etj) dhe të akteve juridike jonormative (CV, kërkesa, konkursi, aplikimi, njoftimi, padia, etj). Për studentët, kjo lëndë është më se e nevojshme, që të përfitojnë shkathtësitë e shkrimit të duhur juridik, si dhe të arsyetimit të duhur të asaj që e shkruajnë juridikisht, sepse mjeshtria e të shkruarit juridik është thelbësore për çdo jurist në punën e tij të ardhshme profesionale.

- **Teknologjia reproduktive e asistuar dhe e drejta**

Kjo lëndë ka për qëllim të theksoj faktin se në shoqërinë bashkëkohore, tanimë nuk ekziston një model universal i familjes dhe prindërisë. Me studimin e lëndës 'Teknologjia Reproductive e Asistuar dhe e Drejta', studentët do të fitojnë njohuri rreth teknologjive të reja për reproduktimin artificial, të cilët janë pjesë e politikës bashkëkohore të natalitetit. Studentët, në detaje do të mësojnë për të gjitha metodat e reja të reproduktimit të qenies njerëzore, duke përfshirë: insimin artificial, in vitro fertilizimi, amësia surrogate, lindja e fëmijës nga një grua me spermë të donuar, reproduktimi post human, ko-prindëria (bashkëprindëria), ngjizja e fëmijës nga tre persona, krioprezervimi i gameteve ose embrioneve. Nëpërmjet kësaj lënde, studentët do të njoftohen se ekzistojnë edhe forma tjera, të cilat shkenca i ofron, por ende konsiderohen procese të ndaluara: klonimi, zgjedhja e gjinisë së fëmijës, përmirësimi i kapaciteteve fizike, intelektuale të fëmijës së ardhshëm (eugenika), etj. Përmes studimit të kësaj lënde, pritet nga studentët, që ta zhvillojnë mendimin e tyre kritik me anë të debateve për dilemat e shumta morale, etike dhe juridike lidhur me këto teknologji të reja për reproduktimin e qenies njerëzore.

- **Dhuna në familje**

Dhuna në familje është një fenomen shoqëror me përmasa dhe shtrirje të gjerë edhe në shoqërinë bashkëkohore. Ajo, është e pranishme në të gjitha shtetet e shoqëritë, pavarësisht zhvillimit dhe emancipimit të tyre. Imunë ndaj këtij fenomeni nuk është as vendi ynë e as rajoni në të cilin jetojmë. Andaj, studentët e drejtësisë përmes kësaj lënde fitojnë njohuri rreth asaj se çfarë është dhuna në familje, format në të cilat ajo manifestohet, rregullimet ligjore në vend, rajon dhe në sferën ndërkombëtare, si dhe mënyrat e parandalimit të saj. Përmes kësaj lënde, studentët në

fund të lëndës, do të jenë në gjendje ta identifikojnë dhunën në familje, t'i identifikojnë veprat penale që inkriminohen në Kodin Penal si dhunë në familje, si dhe të zhvillojnë mendim kritik rreth kësaj problematike. Kjo lëndë e aftëson juristin e ardhshëm që gjatë ushtrimit të profesionit të tij si gjykatës, prokuror apo avokat t'i trajtojë në mënyrë sa më adekuate çështjet nga kjo sferë që kanë ndjeshmëri të lartë, si dhe të ofrojnë ndihmë dhe mbrojtje sa më adekuate për viktimat e këtyre veprave penale.

- **Hyrje në shkencë kompjuterike**

Kjo lëndë paraqet një hyrje të gjerë dhe të integruar në konceptet themelore të shkencave kompjuterike. Lënda mbulon temën, siç janë: historia e llogaritjes; logjika dhe sistemet digjitale; hyrje në arkitekturën kompjuterike, algoritme të thjeshta, zgjidhje problemesh dhe struktura të të dhënave; hyrje në gjuhët e programimit, sistemet operative, bazat e të dhënave, rrjetat, inxhinieria e softuerit dhe ueb-it; llojet e aplikacioneve, përfshirë edhe përshkrimin e disa programeve specifike (procesorë teksti, baza të dhënash, shfletues, etj.); procedimi i të dhënave tradicionale dhe multimediale.

- **Teknologjitë e Internetit**

Qëllimi kryesor i lëndës është që t'u jep studentëve njohuri praktike mbi mekanizmat themelorë, shërbimet dhe protokollet e rrjetit global - Internetit. Lënda ofron mësimin e arkitekturës së përgjithshme të uebfaqeve efikase, skalabile dhe të sigurta. Studentët, do të fitojnë njohuri të thella teknike të XML, XHTML (listat, tabelat, figurat, multimedia dhe formularët), CSS (formatimi, stilet dhe layout-i), si dhe JavaScript (variablat, kushtet, ciklet dhe funksionet).

- **Probabiliteti dhe statistika e zbatuar**

Qëllimi i kësaj lënde është t'i pajisë studentët me njohuritë themelore nga probabiliteti dhe statistika që kanë zbatim të drejtpërdrejtë në fushën e shkencave kompjuterike. Qëllimi është që të mësohet se si bëhet përpunimi i të dhënave statistikore, ligjshmëritë e tyre, paraqitja e tyre, ligjet për dhënie të konkluzioneve përkatëse bazuar në të dhënat e përpunuara, etj. Po ashtu, qëllimi është që të mësohen parimet themelore nga fusha e probabilitetit dhe se si mund të zbatohen ato parime në fushat e ndryshme nga jeta e përditshme posaçërisht në lëmin e shkencave kompjuterike.

- **E-tregtia**

Lënda ka për qëllim t'i mësojë studentët me konceptet themelore dhe me terminologjinë e e-tregtisë (e-commerce): ● historinë e e-tregtisë ● e-botën: e-biznesin dhe e-tregtinë ● modelet e biznesit për e-tregtinë ● sistemet e pagesave online ● marketingun online ● e-infrastrukturat. - T'u mësojë teknologjitë kryesore, të cilat janë të detyrueshme për të drejtuar e-tregtinë në ditët e sotme, duke përfshirë: shërbyesit (serverët), aplikacionet (software), lidhjet e internetit, portat e pagesës dhe sigurinë e tyre, "cookies", etj. - Të bëhet aplikimi i konceptit "e-commerce" nga teoria në praktikë, duke bërë analizë të duhur në modelet e biznesit dhe teknologjive, si dhe marrjen e vendimeve në zgjidhjet më të përshtatshme. - Të sqarohet kuptimi i procesit të krijimit të një dyqani ueb dhe lidhja e tij me sistemet e pagesës (porta pagese / payment gateway). - Studenti të jetë në gjendje ta aplikojë këtë ide të e-biznesit në letër, të krijojë modelin e biznesit dhe të përgatisë financat. - Studenti të jetë në gjendje t'i dallojë mjetet e ndryshme në internet për marketing dhe të jetë në gjendje të zbatojnë disa prej tyre në praktikë. - Shqyrtimi mbi sigurinë e informacionit, etika dhe çështjet sociale si dhe mënyrat për të trajtuar çështje të veçanta. - Studenti të jetë i njohur me internet dhe "cloud" shërbimet.

- **Hyrje në sistemet e informacionit**

Qëllimet e kësaj lënde janë: Të mësohen konceptet themelore dhe terminologjia e sistemeve të informacionit: - Konceptet themelore të sistemeve të informacionit: hardueri, softuerie, rrjetet; - E-World: e-biznes dhe e-commerce; - Zhvillimi i proceseve; Të mësohen sistemet e informacionit dhe të teknologjive që përmirësojnë vlerat e biznesit dhe proceset e ndryshme brenda organizatave; Aplikimi i IS koncepteve në disiplina të ndryshme drejtuese, gjatë analizës, interpretimit, vlerësimit dhe vendimeve; Kuptimi i procesit të ridizajnit të organizatave duke përdorur sistemet e informacionit; Përshkrimi i rolit të sistemeve të informacionit në vendimmarrje; Shqyrtimi i sigurisë së informacionit, etikës dhe çështjeve sociale; Njoftimi me internetin, tregtinë elektronike dhe e-biznesin; Përgatitja e studenteve për të punuar në projekte të vogla, puna individuale apo grupe, të cilët nga natyra mund të bien në këto kategori: studimet e rastit, projektit kërkimor shkencor, projekte zhvillimore ose projekte praktike;

- **Etika profesionale e TI**

Lënda siguron qasje gjithpërfshirëse në çështjet aktuale etike me rastin e shfrytëzimit të teknologjive të informacionit (TI). Vlerëson një sërë çështjesh të shtrura në vitet e kaluara dhe ato të tanishmet me të cilat ballafaqohen shfrytëzuesit e TI-së, duke filluar nga liria e të shprehurit, privatësia, pronësia intelektuale, hakerimi, dhe vazhdon me epokën e re, shfrytëzimin etik të rrjetave sociale dhe komunitetet online. Trajtohen dilemat etike dhe përgjegjësitë etike të profesionistëve të TI-së, si dhe promovohet vlerësimi kritik dhe shfrytëzimi i përgjegjshëm i TI-së.

- **Gjuhë shqipe me kulturë shkrimi**

Lënda Gjuhë Shqipe me Kulturë Shkrimi është një sintezë e rregullave dhe udhëzimeve, të cilat janë të parapara për t'i përmirësuar shkathtësitë e të shprehurit me shkrim dhe me gojë në gjuhën shqipe. Përmirësimi i këtyre shkathtësive, para së gjithash, parashihet që të realizohet përmes familjarizimit me rregullat drejtshkrimore dhe disa norma morfologjike e sintaksore të gjuhës shqipe që shihen si të nevojshme që të arrihet përdorimi i drejtë i gjuhës. Më pas, theks i veçantë i kushtohet motivimit të studentëve për ligjërim të rrjedhshëm, rritjes së vetëdijes për përdorimin e gjuhës së pastër dhe standarde shqipe. Gjithashtu, hapësirë të veçantë zë edhe nxitja e vullnetit për përmirësim të procesit të të shkruarit, duke i vetëdijësuar studentët për dallimet e llojeve të teksteve të shkruara, por edhe për vetëdijen për integritet akademik në punimet serioze kërkimore (plagjiaturën), duke mos lënë pas as përfshirjen e terminologjisë specifike të fushave të ndryshme në të cilat janë të orientuara studentët. Të gjitha këto tema janë parapara që studentëve t'u ofrohen si njësi mësimore të kombinuara, gjegjësisht si rregulla, udhëzime e ushtrime që plotësohen mes veti.

- **Gjuhë gjermane 1-4**

Me përfundimin e lëndës, nga studentët pritet që të kenë fituar njohuri të duhura në përputhje me Kornizën Evropiane të Gjuhëve (të përcaktuara saktësisht në nivele). Përveç kësaj, pritet që studentët të bëhen më të pavarur dhe më të përgjegjshëm ndaj mësimit të gjuhës. Deri në fund të lëndës, studentët do të jenë në gjendje që në mënyrë kritike të reflektojnë mbi tema të ndryshme dhe të japin përfundime. Studentët, gjithashtu do të jenë në gjendje t'i shprehin mendimet dhe opinionet e tyre në formë të shkruar dhe gojarisht në gjuhën gjermane.

- **Multikulturalizmi në mësimdhënien e gjuhës angleze**

Qëllimet e programit të lëndës: Aftësi komunikimi: Studentët pritet të jenë në gjendje të prezantojnë opinionet e tyre në lidhje me kulturën dhe globalizimit dhe e gjithë kjo reflektohet në procesin e arsimit. Pritet të diskutohen tema lidhur me tolerancën, mirëkuptimin, dhe akomodimin e diversitetit. Ata, gjithashtu, do të punojnë drejt përgatitjes të eseve, ku do të trajtohen çështjet e relativizmit kulturor, stereotipeve, paragjytimeve, si dhe zhvillimi i koncepteve të bashkëpunimit ndërkulturor dhe arsimit multikulturor. Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit: Krijimi i modeleve arsimore për bashkëpunim multikulturor dhe zbatimi i tyre në procesin e mësimdhënies së gjuhës angleze si gjuhë e dytë. Zhvillimi i një strategjie arsimore që do të tregohet e suksesshme në situata ku mund të ketë tensione në mesin e studentëve për shkak të mungesës së tolerancës. Aftësitë për të vlerësuar: Përpunimi i portofolit individual të bazuar në parimet e arsimit multikulturor dhe kapacitetit, si dhe identifikimi i rasteve kur ka mungesë tolerance, duke synuar zhvillimin e frymës së bashkëpunimit ndërkulturor. Njohuri dhe mirëkuptim: Njoftim me parimet themelore të kulturës, relativizmit kulturor, arsimit ndërkulturor dhe multikulturor dhe adresimi i këtyre çështjeve në kuadrin e mësimdhënies së gjuhës angleze si gjuhë e huaj. Aftësitë e të mësuarit: Njoftim me modelet efikase për promovimin e multikulturalizmit në procesin arsimor, ku gjuha angleze do ta ketë rolin më të rëndësishëm, si gjuhë neutrale për studentët, pavarësisht nga përkatësia etnike.

- **Studime ndërkulturore**

Pasi ta kenë përfunduar lëndën, studentët, do të mund t'i identifikojnë çështjet globale dhe problemet nga perspektiva e kulturave të ndryshme, dinamikën e komunikimit në kulturat tjera, ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet vlerave të tyre dhe ato të kulturave tjera, si dhe ngjashmëritë dhe dallimet e praktikave të komunikimit të tyre dhe të kulturave tjera. Aq më shumë, nga studentët pritet që të bëhen më të vetëdijshëm për stereotipat që shoqëria i ka për kulturat e ndryshme dhe, si pasojë, më mirë do ta kuptojnë vendin e tyre në komunitetin global. Studentët, do të fillojnë të mendojnë në mënyrë kritike mbi tema rreth etnisë së tyre, identitetin gjinor, klasën, fenë, origjinën kombëtare, moshën si dhe karakteristika të tjera demografike dhe ndikimin e tyre në procesin e komunikimit. Pas përfundimit të lëndës studentët do të fitojnë aftësi të komunikuarit të nevojshme për punën në grupe përmes pjesëmarrjes së tyre në hulumtime dhe gjithashtu do të fitojnë aftësi për t'i prezantuar këto projekte kërkimore.

- **Arsyetimi dhe mendimi kritik**

Pas përfundimit të suksesshëm të lëndës, studentët, do të jenë në gjendje që ta përmirësojnë mënyrën e tyre të të menduarit, përmes të kuptuarit të strukturave të brendshme të procesit të të menduarit dhe duke i rishikuar ato në kuadër të standardeve individuale dhe akademike. Ata, do të zhvillojnë strategji të vendimmarrjes, të bazuara në reflektim, arsye dhe logjikë. Përmes kësaj lënde, studentët, do të mësojnë se në bazë të cilave tendenca, ngjashmëri dhe supozime bazohen reflektimet e tyre, si dhe cilat kushte dhe pasoja lindin nga mënyra e tyre e të menduarit. Ky mendim reflektues, nënkupton një rishikim aktiv, të kujdesshëm dhe të vazhdueshëm të të gjitha besimeve individuale në lidhje me fundamentin që i mbështesin ato dhe konkluzionet që dalin prej tyre. Studentët pritet të fitojnë njohuri dhe aftësi për të marrë vendime të kapshme, të nevojshme në mjedisin e përditshëm në lidhje me profesionet e tyre të ardhshme.

- **Marrëdhëniet me publikun dhe mediat e reja**

Lënda, do të fokusohet në zhvillimin e aftësive komunikuese dhe të teknikave që janë të domosdoshme për

funksionimin efektiv në epokën e globalizimit. Studentët, do ta përpunojnë procesin e globalizimit, aspektet sociale, aspektet politike, ekonomike dhe kulturore të fenomenit modern, si dhe pasojat dhe ndikimet në sferën e komunikimit, të cilat njëherësh karakterizuan edhe një epokë të postmodernizmit, veçanërisht ndikimin e mediave të reja sociale, strukturën dhe funksionin e tyre, multilingualizmin në rrjetet sociale, efektet dhe pasojat në realitetet moderne të komunikimit në botë.

- **Media dhe shoqëria**

Mediat dhe Shoqëria paraqet hyrje të studentëve në një disiplinë, e cila i studion marrëdhëniet komplekse mes mediave dhe shoqërisë, rolin e mas mediave si teknologji ndërmjetësuese gjatë komunikimit masiv dhe global. Qëllimi i veçantë i lëndës janë implikimet politike, sociale dhe kulturore të mediave mbi shoqërinë.

- **Hyrje në ekonomi dhe biznes**

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është ta zhvillojë kuptimin bazik të koncepteve dhe teorive kryesore ekonomike, të cilat përdoren për analizë të çështjeve ekonomike. Kjo lëndë është e dizajnuar në atë formë që t'u mundësojë studentëve të pajisen me njohuri për parimet bazë, me konceptet dhe teknikat në fushën e ekonomisë si shkencë, si dhe në analizat ekonomike. Kjo lëndë siguron hulumtimin e parimeve të mikroekonomisë dhe makroekonomisë, duke u fokusuar në implementimin e dijes në sjelljen e vendimeve në një ambient global. Pas mbarimit të lëndës, studentët duhet të aftësohen: ta përdorin modelin e ofertës dhe kërkesës dhe ta përcaktojnë ndikimin e ndryshimeve të kërkesës dhe ofertës mbi çmimin dhe sasinë; ta definojnë PBB (GDP) dhe të kalkulojnë matjen, përdorimin dhe kufizimin e PBB (GDP), si një mjet i mirëqenies ekonomike; ta definojnë inflacionin dhe ta kalkulojnë atë, të njihen me pasojat dhe si të përshtaten në to; si dhe t'i përshkruajnë rolet dhe mjetet e bankës qendrore.

- **Parimet e menaxhmentit**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët që njoftohen me bazat e menaxhmentit, gjenezën dhe përkufizimin e tij, si dhe me parimet themelore në të cilat do të bazohet puna e secilit menaxher të ardhshëm. Ndjekja e kësaj lënde ka për qëllim që studentët të përfitojnë njohuri themelore nga fusha e funksioneve bazike në menaxhment si planifikimi, organizimi, koordinimi, motivi dhe kontrolli. Të mësuarit e kësaj lënde studentëve do t'u mundësojë: - T'i mësojnë bazat e menaxhmentit dhe të aftësohen për to që të japin shembuj konkretë. - Të aftësohen ta shohin këtë lëndë si nevojë për fitimin e njohurive, të cilat do të jenë në kontekst të zbatimit në praktikë të asaj që kanë mësuar. - Të mendojnë në mënyrë efikase që do t'u ndihmojë të përballen me problemet afariste në jetën e tyre të mëtutjeshme.

- **Komunikimi afarist**

Qëllimi i kësaj lënde është që t'i njoftojë studentët me konceptet e komunikimit të biznesit. Përmbajtja e programit është si në vijim: në vitet e fundit gjithnjë e më shumë kompani i përdorin teknikat e komunikimit të biznesit si një mjet kyç për t'u përgjigjur konkurrencës gjithnjë e më të ashpër në tregun global. Kjo lëndë është një përpjekje për t'i përmirësuar aftësitë e komunikimit të studentëve me tregues teorikë dhe para së gjithash me demonstrime praktike të mënyrës së drejtë të komunikimit në një mjedis organizativ me të punësuarit dhe menaxherët, si dhe mbajtjes së takimeve, intervistimin, se si të përgjigjen gjatë intervistës, negociimi dhe motivimi i të gjithëve në rrethin tyre.

- **Menaxhimi i projekteve**

Qëllimi lëndës është që të inkuadrohen studentët në botën e projekteve moderne dhe t'i ballafaqojë ata me mundësitë dhe me sfidat e jetës reale ekonomike në krijimin e projekteve të përshtatshme për nevojat reale. Qëllimet specifike të lëndës janë: si të përcaktohet një projekt i caktuar (duke përdorur disa faza) dhe të theksohet roli i rëndësishëm i menaxherit të projektit (të kuptohen nevoja, fusha e veprimit, aktivitetet për implementim, kompleksiteti i dizajnit modern, etj.). Studentët duhet të trajnohen se si të aplikojnë mjete dhe teknika moderne të menaxhmentit modern të projektimit me rastin e transformimit të nevojës, ose të ideojnë krijuese në një projekt real e të dokumentuar, i cili do të bëjë të jenë më inventivë për vete dhe më kompetitivë në tregun më konkurrues të punës.

- **Plani i biznesit**

Qëllimi i lëndës është që t'u ndihmojë studentëve për të kuptuar sjelljen e vetëdijshme të ndërmarrjes në kushtet bashkëkohore të afarizmit.

- **Etika dhe përgjegjësia shoqërore e korporatave**

Qëllimi i lëndës është që të zhvillojë njohuri të përgjithshme teorike të përgjegjësisë korporative sociale në ekonominë moderne dhe të analizojë reflektimin e përgjegjësisë korporative sociale në funksionimin e përgjithshëm të ndërmarrjes.

- **Gjuhë frënge 1-2-3**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët t'i forcojnë bazat dhe aftësitë gjuhësore, si dhe t'i zhvillojnë katër kompetencat e komunikimit, veçanërisht në fushat e mëposhtme: të jenë në gjendje të shprehin një mendim, • të jenë

në gjendje t'i shprehin ndjenjat, • ta kuptojnë thelbin e një shprehje, mendimi apo ideje, • të jenë të aftë të argumentojnë dhe mbrojnë mendimin e tyre. • të gjinden në situata të ndryshme, • të mbajë një fjalim të thjeshtë dhe koherent, • të rrëfejnë një ngjarje, • të rrëfejnë një ëndërr ose përvojë, • të paraqesin arsyet për një projekt ose ide, • të komunikojnë në mënyrë spontane.

- **Gjuhë italiane 1-2-3**

Qëllimi i mësimdhënies është që studentët të njihen me kulturën italiane, civilizimin Italian dhe gjuhën italiane. Ideja është që studentët të njohin një realitet tjetër, i cili do t'u ndihmojë në formimin e një ego të vetes, po ashtu edhe në krijimin e një fotografie për veten dhe të ardhmen e tyre. Në përputhje me nivelin (nga A1 deri B2), të cilën studentët do ta zgjedhin, ose nivelet, që do t'i ndjekin në semestrat që i kanë në dispozicion si një lëndë zgjedhore, materia thellohet në mënyrë progresive. Në nivelin e parë fillohet me të dhënat bazike, si p.sh: drejtshkrimi, shqiptimi, terminologjia për menaxhimin me situatat e ndryshme gjuhësore të përditshmërisë (prezantimi i vetes, prezantimi i të tjerëve, orientim në hapësirë dhe kohë, shprehje komunikuese në ndonjë lokal, në restorant, supermarket, në treg), ndërsa arrihet deri në konstruksione më të ndërlikuara në nivelet në vazhdim, që kanë të bëjnë me dhënien e një qëndrimi, dëshire, nevojë, sqarimi të ndodhive të shkuara, të folur të ndodhive të ardhshme, etj. Gramatika prezantohet në mënyrë induktive (nëpërmjet vetëdijesimit nga situatat (audio incizime, video filma, tekste) dhe sjellje të konkluzioneve), në të cilën rolin kryesor e kanë vetë studentët, me pjesëmarrjen e tyre aktive në ligjëratat.

- **Të shkruarit akademik në gjuhën angleze**

Në këtë lëndë do të zhvillohen shkathtësitë akademike të të shkruarit të studentëve në mënyra të ndryshme. Studentët, do të aftësohen t'i komunikojnë idetë e tyre në mënyrë të qartë, të rrjedhshme dhe efektive që të prodhojnë një pjesë të shkruar. Gjithashtu, studentët do të njoftohen me rregullat e citimit dhe parafrazimit dhe do të vetëdijësohen se çka është plagjiatura. Informata kthyesë e një pjese të shkruar, do të përfshijë vetëkorrigjimin, korrigjimin e njëri-tjetrit dhe korrigjimin nga ana e mësimdhënësit të përmbajtjes, organizimit dhe gabimeve gjuhësore gjatë procesit të të shkruarit.

- **Arsimim online dhe digjital**

Lënda Arsimimi Online dhe Digjital, është lëndë një-semestrale me 3 orë në javë, e cila ofrohet në studimet deridiplomike. Lënda është e përpiluar në bazë të nevojave të studentëve dhe në vete ngërthen shkathtësi të ndryshme të shekullit 21, të cilat janë të lidhura me përdorimin efektiv të teknologjisë. Lënda përmban tri kategori të shkathtësive të shek 21. Pas mbarimit të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të kërkojnë dhe të kenë qasje në informatat online, duke përdorur vegla të ndryshme digjitale, të vlerësojnë në mënyrë kritike vërtetësinë e materialeve online dhe të bëjnë dallim mes burimeve të vërteta dhe të rrejshme, të tregojnë mirëkuptim për problemet etike në kontekstin akademik, të kuptojnë si përdoren citatat në mënyrë të drejtë, të mësojnë si kryhet komunikimi profesional në mënyrë efikase, t'i kuptojnë gjërat bazike të sigurisë në internet, si dhe aspektet pozitive dhe negative të krijimit të identitetit online, ta hetojnë shqetësimin-sajber dhe t'i identifikojnë zgjedhjet e mundëshme për zvogëlimin e online shqetësimeve.

- **Gjuhë angleze për bashkëbisedim**

Gjuhë Angleze për Bashkëbisedim është lëndë një-semestrale e hartuar për folësit e gjuhës angleze të nivelit të mesëm dhe më lartë. Lënda, do të jetë në dispozicion për studentët në të gjitha semestrat. Anglishtja është një gjuhë ndërkombëtare, që e lehtëson komunikimin në kontekste të ndryshme në mbarë botën, duke filluar nga takimet e biznesit dhe transaksionet në bisedat e rastësishme midis miqve dhe ndërveprimeve gjatë udhëtimit. Anglishtja, në bisedë, do të ndërtojë aftësitë e të dëgjuarit dhe të folurit e studenteve, duke ofruar gramatikë, fjalorin, shqiptimin dhe praktikën e rrjedhshmërisë së nevojshme për llojet e zakonshme të ndërveprimeve të folura angleze. Lënda do të mbulojë tema që lidhen me bisedën profesionale, bisedat e rastësishme dhe ndërveprimet e përditshme, duke u siguruar studentëve besimin e bisedave në një kontekst të ndryshëm. Biseda profesionale, do të përfshijë lloje formale dhe të sjellshme të fjalimit të përdorura në kontekste të tilla, si takime pune, ose diskutime me kolegët. Biseda e rastësishme, do të përfshijë praktikën me gjuhën e përdorur gjatë shoqërimit me miqtë, ose familjen dhe situata të tjera joformale dhe do të përfshijë zhargon dhe fjalim joformal. Ndërveprimet e përditshme, do të përfshijnë biseda në dyqane, gjatë udhëtimit dhe duke kërkuar ndihmë. Metodatat e të mësuarit, do të fokusohen në praktikë dhe do të përfshijnë aktivitete dëgjimi, dialogë, role , simulime, debate dhe diskutime.

- **Shkathtësi komunikuese në kontekst profesional në anglisht**

Qëllimi i lëndës është të zhvillojë aftësitë e komunikimit që janë thelbësore për funksionimin efektiv në botën profesionale në anglisht. Objektivat e lëndës përqendrohen në një gamë të gjerë mjedisesh dhe çështjesh profesionale. Studentët, do të hulumtojnë procesin e analizës së situatave të ndryshme të komunikimit dhe në përputhje me rrethanat do t'i kuptojnë ato.

- **Beletristike dhe argëtim**

Lënda synon të eksplorojë një sërë tekstesh tërheqëse dhe të njohura letrare (romane, fragmente, lektura dhe tregime të shkurtër), në mënyrë që të kuptohen dhe shijohen karakteristikat e zhanreve të ndryshme të njohura, duke përfshirë trillimet shkencore, letërsinë për të rinj dhe fantastikën. Ndër objektivat e lëndës, mund të përfshihen me sa vijon: të zhvilluarit e vetëbesimit të studentëve, rrjedhshmërisë dhe interesit për të lexuar në anglisht, të lexuarit e llojeve të ndryshme të romaneve dhe dhënies së përgjigjeve të logjikshme dhe të mprehta, me gojë dhe me shkrim, duke krijuar një lidhje midis përvojës personale, njohurive globale dhe/ose burimeve të tjera (leksioneve, teksteve të leximit, filmave) dhe tekstit të caktuar. Për më tepër, qëllimet janë transferimi i aftësive të përparuar të leximit në klasën e gjuhës së dytë dhe zhvillimi i këtyre aftësive, duke i bërë studentët lexues më të mirë në të dy gjuhët. Shkathtësitë e të lexuarit përfshijnë: përshkrimin, skanimin, parashikimin, të qëlluarit e fjalëve nga konteksti dhe leximin për një kuptim më të hollësishëm.

- **Letërsi angleze dhe filmi**

Kjo lëndë është e dedikuar për studentët që duan të lexojnë, të kënaqen duke parë filma dhe duke i analizuar ata. Qëllimet e lëndës janë, si vijon: - të ndihmuarit e studentëve të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik përmes analizës së filmit; - diskutimi, vlerësimi dhe përpilimi i komenteve kritike; - analiza kritike e teksteve letrare dhe informuese; - diskutimi dhe analiza e punës së studentëve dhe vlerësimi nga kolegët/shokët; - paraqitja e perspektivave të ndryshme, mbështetja e pretendimeve, përdorimi i gjuhës shqisore.

- **Gjuha maqedonase për terminologji juridike dhe të BE**

Qëllimi i lëndës është t'i aftësojë studentët për kompetencë dhe performancë gjuhësore në fushën profesionale (d.m.th. në fushën e të drejtës dhe BE-së). Bëhet fjalë për një koncept të përqendruar te studenti (learner-centered approach), e që thekson zhvillimin e aftësive të komunikimit në fusha specifike, d.m.th. thellimin dhe përfundimin e aftësive për shprehje të përparuar me shkrim dhe me gojë në gjuhën standarde maqedonase. Materiali i synuar përfshin përmbajtje në lidhje me disiplinat profesionale, si dhe dokumente dhe materiale autentike. Vëmendje e veçantë i kushtohet zotërimit të terminologjisë profesionale dhe zbatimit të saj në kontekst të përshtatshëm gjuhësor dhe zhvillimit të aftësive digjitale. Studentët pritet të bëhen më autonomë në mësimin e gjuhës dhe të jenë në gjendje të mendojnë në mënyrë kritike për një larmi temash, si dhe të fitojnë aftësinë për të komunikuar në gjuhën maqedonase në një mjedis shumëgjuhësh dhe multikulturor.

- **Hyrje në metodologjinë dhe teknikën e shkrimit shkencor**

Qëllimi i kësaj lënde është sqarimi i metodologjive dhe teknikave të punës shkencore, të cilat para së gjithash tek studentët e rinj krijojnë vështirësi. Ushtrimet praktike, duhet të ndihmojnë për mënyrën si duhet të orientohemi në bibliotekë, si të shkruajmë punim me shkrim, referate dhe të ngjashme. Në kuadër të kësaj lënde, do të përfshihen këto tema: përcaktimi i temës, bibliografia, rregullat e citimit, të dhënat shkencore, organizimi i punës etj.

- **Letërsia moderne gjermane**

Kjo lëndë ka për qëllim të ofrojë qasje në historinë e letërsisë gjermane të shekullit 20. Nga studentët pritet njohje me veprat dhe autorët më të njohur të kësaj periudhe me qëllim të kuptimit të mënyrës së të menduarit dhe të krijimit të letërsisë gjermane të shekullit 20. Lënda duhet t'i aftësojë studentët të depërtojnë në interpretimin e teksteve të ndryshme të kësaj periudhe dhe në krijimin e teksteve të shkruara. Me këtë lëndë studentët do të fillojnë me njohjen e lëvizjeve evropiane dhe vlerës së literaturës dhe gjendjes sociale përgjatë Evropës. Me këtë lëndë parashihet analiza e veprave dhe autorëve në këtë periudhë të letërsisë gjermane, si për shembull poetika e autorëve nga periudha e letërsisë gjermane pas luftës së dytë botërore në Gjermani 1945 – 1949. Letërsia gjermane 1949-1961, 1961-1977 dhe 1978-1989.

- **Përvetësimi i gjermanishtes si gjuhë e huaj**

Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të njihen me problemet themelore të teorisë së të mësuarit të gjermanishtes si gjuhë e huaj, me aspektet e ndryshme të mësimin të gjuhëve të huaja. Në kuadër të lëndës, do të sqarohen modelet kryesore të mësimin të gjuhës së huaj dhe të dytë (për shembull mësimi me vetëdije dhe mësimi pa vetëdije), mënyrat e dygjuhësisë, respektivisht shumëgjuhësisë; modele psikolinguistike të bazuara të ligjëratave (p.sh. teoria e monitorimit, fokusim të formave, qasje interaktive), rezultate kërkimore për L2- nivelin e mësimin të gjuhëve, për lateralizim, etj., qasje sociolinguistike (regjistër i thjeshtëzuar, codeswitch, etj.); të ndryshueshme individuale, si moshë, ose stili njoftojës; koncepte të zgjeruara, si p.sh. psikologjia e krahasimit të kulturave. Përveç kësaj, do të diskutohet rreth faktorëve, siç janë: motivimi, moshë dhe grupi i gjuhëve.

- **Civilizimi i vendeve gjermanfolëse**

Qëllimi i kësaj lënde është t'i informojë studentët me bazat e kulturës dhe civilizimit gjerman, me ideologjitë, periudhat shkencore-teknologjike, politike-historike, shoqërore dhe kulturore, zhvillimet, rastet dhe arritjet e rrethit kulturor të Gjermanisë dhe kulturës gjermanfolëse përgjatë shekujve. Një vështrim i posaçëm, do të bëhet mbi problemet në vijim: shqyrtimi i historisë gjermane ndërmjet periudhës së shekullit 19 dhe 20, shqyrtimi i autorëve,

ideve, koncepteve dhe ndikimi i filozofisë gjermane, muzikës gjermane, shkencave gjermane (a. shkencat kulturore; b. teknologjitë), shkencat tjera gjermane, etj.

- **Politika gjuhësore në UE**

Qëllimi i kësaj lënde është t'i njoftojë studentët me problemet e politikës gjuhësore, si dhe me shumëgjuhësinë në BE. Çka është në të vërtetë politika gjuhësore dhe kush e menaxhon atë? Përkrah sqarimit të këtyre pyetjeve, do të tematizohen edhe fillimet e politikës gjuhësore gjermane dhe problemet aktuale, në veçanti në lidhje me BE-në. Cilin rol e luan gjuha gjermane dhe gjuhët tjera me rëndësi, si p.sh: gjuha angleze, frënge, spanjolle, etj. Në institucionet e BE-së? A është përparësi për personat nga vendet gjermanfolëse nëse gjuha e tyre luan rol të rëndësishëm në institucionet e BE-së? Nëse përgjigja është po, si mund të forcohet pozita e gjuhës gjermane si gjuhë zyrtare në institucionet e BE-së? Në këtë kontekst, do të diskutohen pozitat e ndryshme të politikës gjuhësore në BE. Kjo lëndë i përmbush dhe i thellon njohuritë themelore nga kjo fushë.

- **Analiza e gabimeve**

Si mësimdhënës, në rast të gjermanishtes si gjuhë e huaj, qëllimi ynë është t'i mësojmë studentët tanë të flasin dhe të shkruajnë në gjuhën gjermane pa gabime. Përsëri, mësimi është një proces gjatë së cilit secili njeri bën gabime dhe çdoherë mëson nga ato gabime. Pra, ne nuk duam vetëm t'i identifikojmë dhe t'i analizojmë gabimet e ndryshme, por gjithashtu të reflektojmë me përballje me gabimet dhe ato t'i njohim si instrumente diagnostike. Gjithashtu, do të merren parasysh edhe problemet e gjuhësisë kontrastive.

- **Praktikum**

Lënda ka për qëllim t'i njoftojë studentët me metodën e vëzhgimit të mësimin në orë, vëzhgimin e aspekteve metodologjike dhe didaktike, mësimin interaktiv, sjelljen e mësimdhënësit, zgjedhjen e situatave problematike në mësimin praktik, llojet e nxënësve, marrëdhëniet me nxënësit problematikë, evaluimin, përpunimin e portfoliove dhe protokolleve. Në këtë lëndë, do të përfshihen edhe hospitimet me nga 20 orë nga gjuha gjermane nëpër shkollat fillore, shkollat e mesme, gjimnazet dhe institucionet e ndryshme arsimore dhe në bazë të të cilave do të zhvillohen protokolle dhe do të bëhet vlerësimi i tyre. Secili student gjatë këtij semestri, duhet të zhvillojë në mënyrë të pavarur 3-4 modele të orëve dhe një orë praktike (provim). Gjatë këtyre orëve, duhet të implementohen të gjitha dituritë e diferencuara dhe dituritë teorike dhe praktike, të cilat janë përvetësuar gjatë semestrave paraprak.

- **Civilizimi zviceran dhe austriak**

Kjo lëndë ka për qëllim të japë qasje në historinë e teorive të kulturës dhe civilizimit të Zvicrës / Austrisë. Do të përfshihen temat vijuese: përpunim i terminologjisë në raport me zhvillimin e veçantë të Zvicrës dhe Austrisë. Gjithashtu, do të jepet një pasqyrë mbi epokat e kulturës dhe civilizimit zviceran në kontekstin evropian dhe botëror. Hulumtimet e recepcioneve të kulturave jashtëzvicere dhe jashtaustriake në Evropë (në veçanti gjermane, italiane, frënge dhe retoromane), të ndikimeve të kultures zvicerane në pjesën tjetër të Evropës dhe të botës. Aplikimi i perspektivës kontekstuale dhe krahasuese në epokat e caktuara të kulturës, civilizimit dhe historisë zvicerane dhe austriake nga fillimet deri më sot. Përpunimi i personaliteteve dhe ngjarjeve të rëndësishme, duke theksuar pasojat në Zvicrën e Austrinë moderne, respektivisht në Evropë.

- **Analiza e teksteve letrare**

Qëllimi i kësaj lënde është përpunimi i bazave të teorisë dhe të moduseve të zbatimit analitik-interpretues të drejtimeve më të rëndësishme të kritikës letrare, analizës letrare. Fokusim në: a) zbatim i analizës diskurse në punën me vepra letrare, b) zbatim i teorisë de-konstruktive, c) zbatim i intertekstualizmit në punën me tekste konkrete letrare.

- **Ortografia e re gjermane**

Qëllimi i kësaj lënde është njoftimi i studentëve me risitë dhe reformat kryesore të drejtshkrimit të gjuhës standarde gjermane përmes shfaqjes sistematike të rregullores së përgjithshme në të gjitha sferat e drejtshkrimit gjerman. Prandaj, qëllimi i lëndës është që t'i bëjë pjesëmarrësit të sigurt në përdorimin e drejtshkrimit gjerman dhe t'u japë atyre siguri në identifikimin e gabimeve drejtshkrimore, etj.

- **Shkrim kreativ**

Lënda ka për qëllim aftësimin e studentëve në shfaqjen e ideve, ndjenjave, mendimeve në mënyrën e tyre në të shkruar. Në kuadër të kësaj lënde, do të përpunohen, para së gjithash, modele të ndryshme të të shkruarit, të cilat do të përpunohen në pajtueshmëri me fazat e tyre specifike. Të gjitha procedurat, do të sqarohen në detaje. Ky aktivitet është i ndërlidhur me qëllimet në vijim: - Shprehja e interesave personale; - Autonomia e përpilimit të mesazheve; - Vetëbesimi në lidhje me gjuhën e huaj. - Qëndrimi ndaj gjuhës: mjet për komunikim; - Promovimi i shkathtësive për të

shkruar; - Përdorimi i drejtë i kompetencave gramatikore; - Zhvillimi i stilit personal në të shkruar;